

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SUHAREKË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **624-26-4720-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Asfaltimi i rruges ne Bjeshket e Vraniqit - faza e tret ne Vraniq**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	SEFERI-CO SH.P.K.
NUI	810100537
Adresa	Gjinoc-Suharekë
Vendi	Suharekë
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bujar Seferaj
Adresa elektronike	sefericompany@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	06.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Asfaltimi i rruges ne Bjeshket e Vraniqit - faza e tret ne Vraniq

Kerkese per sqarim :23.06.2026

Kerkese per rishqyrtim:30.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kerkese per sqarim :23.06.2026

Kerkese per rishqyrtim:30.06.2026

Pergjigje ne kerkesen per sqarim:01.07.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP-së – trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi, transparenca dhe konkurrenca e lirë.

Neni 16 i LPP-së – përgatitja dhe planifikimi i procedurës, pasi kriteret nuk janë arsyetuar me nevojat reale të kontratës.

Neni 27 dhe 28 i LPP-së – specifikimet teknike, sepse disa kriteret janë të paqarta dhe kufizuese.

Neni 49 i LPP-së – kapaciteti teknik dhe profesional, pasi kriteret nuk janë dëshmuar si të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcionale.

Neni 52 i LPP-së – kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, sepse disa janë të paqarta, të pamatshme dhe krijojnë hapësirë për interpretim.

Neni 53 i LPP-së – kërkesat dhe specifikimet në Dosjen e Tenderit duhet të jenë të qarta, objektive dhe jodiskriminuese.

Neni 59 i LPP-së – vlerësimi i tenderëve, sepse kriteret e paqarta mund të çojnë në vlerësim jo të barabartë.

Neni 108/A i LPP-së – kërkesa për rishqyrtim, sepse AK nuk i ka shqyrtuar individualisht pretendimet dhe nuk ka dhënë arsytim të mjaftueshëm.

Neni 109 i LPP-së – e drejta për ankesë në OSHP, sepse përgjigjja e vonuar në kërkesën për sqarim ka rrezikuar ushtrimin efektiv të mjetit juridik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Referoju Ankesit 1

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne kete faze nuk ka deme matriale

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT (OSHP)

ANKESË

Kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim dhe kundër dispozitave të kundërligjshme të Dosjes së Tenderit

Ankues

SEFERI-CO SH.P.K.

NUI: 810100537

Adresa: Gjinoc, Therandë

Përfaqësues: Bujar Seferaj

Autoriteti Kontraktues

Komuna e Suharekës

Aktiviteti i Prokurimit

"Asfaltimi i rrugës në Bjeshkët e Vraniqit – Faza e tretë në Vraniq"

Nr. i Prokurimit: 624-26-4720-5-2-1

I. HYRJE

Në pajtim me nenet 109 dhe 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Operatori Ekonomik SEFERI-CO SH.P.K. paraqet këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues me

të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim e paraqitur nga ankuesi, si dhe kundër dispozitave të Dosjes së Tenderit që cenojnë parimet dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Kjo ankesë nuk paraqitet vetëm për shkak të refuzimit formal të kërkesës për rishqyrtim, por mbi të gjitha për shkak se Autoriteti Kontraktues ka dështuar të përmbushë detyrimet e tij ligjore për të shqyrtuar në mënyrë të plotë, objektive dhe të arsyetuar pretendimet e Operatorit Ekonomik. Vendimi i nxjerrë nuk përmban analizë teknike, juridike apo faktike për asnjërin nga pretendimet konkrete të ngritura, por kufizohet në konstatime të përgjithshme, pa dhënë shpjegime mbi domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e kriterëve të kontestuara.

Çdo kriter teknik ose profesional duhet të jetë:

- i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës;
- objektivisht i nevojshëm për realizimin e saj;
- proporcional me natyrën dhe vlerën e kontratës;
- i tillë që nuk krijon kufizime të panevojshme për konkurrencën.

Këto kërkesa burojnë drejtpërdrejt nga nenet 7, 16, 49, 52 dhe 53 të LPP-së dhe nga parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës efektive.

Në rastin konkret, Dosja e Tenderit përmban një numër të konsiderueshëm kriteresh teknike dhe profesionale të cilat janë formuluar në mënyrë të paqartë, të pajustificuar ose joproportionale. Për secilin prej tyre, ankuesi ka kërkuar sqarime dhe më pas ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim, duke kërkuar që Autoriteti Kontraktues të identifikojë bazën teknike dhe ligjore të vendosjes së kriterit, lidhjen e tij me paramasën dhe arsyetimin mbi domosdoshmërinë e tij.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar asnjë analizë konkrete. Në vend të saj, ai është mjaftuar me deklarime të përgjithshme se kriteret janë proporcionale dhe se pretendimet e Operatorit Ekonomik janë të pabazuara. Një qasje e tillë nuk përmbush standardin e arsyetimit administrativ dhe nuk i mundëson Operatorit Ekonomik të kuptojë bazën reale mbi të cilën janë

refuzuar pretendimet e tij, as Organit Shqyrtues të ushtrrojë kontroll efektiv mbi ligjshmërinë e vendimit.

II. KRONOLOGJIA E PROCEDURËS

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugës në Bjeshkët e Vraniqit – Faza e tretë në Vraniq".

Më 23.06.2026, Operatori Ekonomik ka paraqitur kërkesë për sqarim, duke ngritur pyetje konkrete lidhur me kriteret teknike dhe profesionale të Dosjes së Tenderit.

Për një numër të konsiderueshëm pyetjesh, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë përgjigje konkrete ose nuk ka ofruar fare përgjigje, megjithëse ishte i detyruar ta bënte këtë brenda afateve ligjore.

Si rezultat i mungesës së sqarimeve dhe duke konsideruar se kriteret mbetën të kundërligjshme, më 30.06.2026 Operatori Ekonomik paraqiti kërkesë për rishqyrtim.

Me vendimin e datës 02.07.2026, Autoriteti Kontraktues e refuzoi kërkesën për rishqyrtim, pa trajtuar individualisht pretendimet e ngritura dhe pa paraqitur arsytim teknik apo juridik për kriteret e kontestuara.

Për këtë arsye, në pajtim me nenin 109 të LPP-së, Operatori Ekonomik ushtron të drejtën e tij për ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit

VEPRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES KANË CENUAR TË DREJTËN E OPERATORIT EKONOMIK PËR MJET JURIDIK EFEKTIV

Që në fazën e kërkesave për sqarim, Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me parimet e transparencës, mirëbesimit dhe administrimit të drejtë të procedurës së prokurimit.

Operatori Ekonomik kishte paraqitur kërkesë për sqarim më 23.06.2026, duke ngritur pyetje konkrete lidhur me kriteret teknike dhe profesionale të Dosjes së Tenderit. Në vend që të përgjigjej brenda afatit që do t'i mundësonte Operatorit Ekonomik të ushtronte në mënyrë efektive të drejtën për kërkesë për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka publikuar përgjigjen vetëm më 01.07.2026, ndërkohë që afati ligjor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim kishte qenë praktikisht në përfundim.

Kjo mënyrë e veprimit krijon përshtypjen se Autoriteti Kontraktues ka tentuar ta vendosë Operatorin Ekonomik në lajthitje procedurale, duke e lënë të kuptojë se duhet të presë përgjigjen ndaj kërkesës për sqarim, ndërkohë që një pritje e tillë do ta kishte privuar nga e drejta për të ushtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afatit të përcaktuar me Ligjin për Prokurimin Publik.

Nëse Operatori Ekonomik do të kishte pritur përgjigjen e Autoritetit Kontraktues deri më 01.07.2026, siç do të pritej normalisht në një procedurë transparente dhe në mirëbesim, ai do ta humbiste afatin ligjor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe, rrjedhimisht, edhe mundësinë për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tij në këtë fazë të procedurës.

Për këtë arsye, Operatori Ekonomik, për të mos humbur afatin ligjor, u detyrua të paraqesë kërkesën për rishqyrtim pa pritur përgjigjen e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës për sqarim. Ky fakt dëshmon se Autoriteti Kontraktues, me veprimet e tij, nuk ka krijuar kushtet e nevojshme për ushtrimin efektiv të mjeteve juridike, por përkundrazi ka zhvilluar procedurën në një mënyrë që rrezikonte kufizimin e kësaj të drejte.

Një veprim i tillë është në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, veçanërisht me parimin e transparencës, trajtimit të barabartë dhe mbrojtjes efektive juridike, të garantuara me nenin 7 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik. E drejta për mjet juridik nuk duhet të jetë vetëm formale, por duhet të jetë reale dhe efektive. Autoriteti Kontraktues ka detyrimin të organizojë procedurën në atë mënyrë që operatorët ekonomikë të kenë mundësi reale të analizojnë përgjigjet e dhëna dhe, nëse është e nevojshme, t'i kundërshtojnë ato brenda afateve ligjore.

Në rastin konkret, kjo nuk ka ndodhur. Përkundrazi, mënyra e procedimit nga Autoriteti Kontraktues ka rrezikuar drejtpërdrejt ushtrimin efektiv të së drejtës së Operatorit Ekonomik për kërkesë për rishqyrtim, çka përbën një shkelje procedurale që duhet të merret parasysh nga Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë vlerësimit të kësaj ankese.III. SHKELJET PROCEDURALE TË AUTORITETIT KONTRAKTUES

3.1 Vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk përmbush standardin ligjor të arsytimit

Një nga parimet themelore të procedurës administrative dhe të procedurës së prokurimit publik është detyrimi i Autoritetit Kontraktues që çdo vendim të jetë i arsyetuar, i bazuar në fakte, në dispozita ligjore dhe në një analizë objektive të pretendimeve të paraqitura nga operatorët ekonomikë.

Ky detyrim buron nga:

neni 7 i LPP-së;

neni 49 i LPP-së;

neni 53 i LPP-së;

neni 59 i LPP-së;

neni 108/A i LPP-së;

parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe administrimit të mirë.

Në rastin konkret, vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk përmban asnjë analizë konkrete mbi pretendimet e ngritura nga Operatori Ekonomik, por kufizohet në konstatime të përgjithshme se:

kriteret janë proporcionale;

pretendimet janë të pabazuara;

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur prova;

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në pajtim me LPP-në.

Këto konstatime nuk përbëjnë arsyetim juridik.

Një vendim administrativ nuk konsiderohet i arsyetuar vetëm sepse citon dispozita ligjore ose deklaron se një pretendim është i pabazuar.

Arsyetimi duhet të përmbajë:

faktet mbi të cilat mbështetet vendimi;
analizën e secilit pretendim;
interpretimin e dispozitave ligjore;
arsyet pse pretendimi pranohet ose refuzohet;
lidhjen logjike ndërmjet fakteve dhe përfundimit.

Asnjë nga këto elemente nuk gjendet në vendimin e Autoritetit Kontraktues.

3.2 Autoriteti Kontraktues nuk ka ushtruar vlerësim administrativ

Në procedurat e prokurimit publik, Autoriteti Kontraktues nuk mund të kufizohet vetëm në deklarinë se kriteret janë të ligjshme.

Ai është i obliguar të demonstrojë:

pse kriteri është vendosur;
cili është qëllimi i tij;
pse është i domosdoshëm;
pse është proporcional;
pse nuk ekziston ndonjë masë më pak kufizuese.

Në rastin konkret nuk ekziston asnjë analizë e tillë.

Vendimi nuk përmban:

analizë të projektit;
analizë të preventivit;
analizë të paramasës;
analizë të specifikimeve teknike;
analizë të procesit teknologjik të punimeve.

Për pasojë, nuk është e mundur të kuptohet mbi çfarë baze faktike dhe profesionale Autoriteti Kontraktues ka arritur në përfundimin se kriteret janë proporcionale.

Një vendim i tillë nuk i mundëson as Organit Shqyrtues të Prokurimit të ushtrojë kontroll efektiv mbi ligjshmërinë e tij.

IV. MOSSHQYRTIMI I PRETENDIMEVE TË OPERATORIT EKONOMIK

Një tjetër shkelje serioze procedurale është fakti se Autoriteti Kontraktues nuk ka shqyrtuar individualisht pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim.

Kërkesa për rishqyrtim nuk përmbante pretendime të përgjithshme, por analizë të veçantë për secilin kriter teknik dhe profesional të kontestuar. Për secilin kriter janë kërkuar:

baza ligjore;
baza teknike;
lidhja me objektin e kontratës;
lidhja me pozicionet konkrete të paramasës;
analiza e proporcionalitetit;
arsyetimi mbi domosdoshmërinë e kriterit.

Megjithatë, në vendimin e Autoritetit Kontraktues nuk gjendet asnjë analizë individuale për asnjërin nga këto pretendime.

Nuk është analizuar:

punëtori i certifikuar për instalimin e tubave të kanalizimit dhe ujësjellësit;

ekskavatori me zinxhir gome minimum 18 ton;

makina frezë minimum 13 ton;

freza që montohet në bager maksimum 500 kg;

kamioni minimum 13 ton;

cilindri minimum 26 ton;

traktori bujqësor/pyjor;

freza për eskavator mbi 1.1 ton;

kamioneta me vinç;

spërkatësja për emulsion;

mini skip-i me lopatë.

Për asnjërin prej këtyre kriterëve Autoriteti Kontraktues nuk ka sqaruar:

në cilin pozicion të paramasës mbështetet kriteri;

pse është zgjedhur pikërisht pesha e kërkuar;

pse është zgjedhur pikërisht kapaciteti i kërkuar;

pse nuk lejohen pajisje ekuivalente;

pse kriteri konsiderohet proporcional.

Në vend të kësaj, të gjitha pretendimet janë refuzuar me një arsyetim identik.

Një qasje e tillë është në kundërshtim të plotë me nenin 108/A të LPP-së, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të shqyrtojë në mënyrë reale dhe efektive pretendimet e Operatorit Ekonomik.

Nëse Autoriteti Kontraktues refuzon njëmbëdhjetë pretendime të ndryshme me të njëjtin paragraf standard, atëherë ai nuk ka ushtruar funksionin e rishqyrtimit, por vetëm ka formalizuar refuzimin e kërkesës.

Ky veprim cenon të drejtën e Operatorit Ekonomik për mjet juridik efektiv dhe e bën vendimin të paarsyetuar dhe të kundërligjshëm.

V. BARRA E PROVËS I TAKON AUTORITETIT KONTRAKTUES

Në vendimin e tij, Autoriteti Kontraktues pretendon se Operatori Ekonomik nuk ka provuar se kriteret janë diskriminuese.

Ky interpretim është juridikisht i gabuar.

Operatori Ekonomik nuk ka detyrim ligjor të provojë pse një kriter është i panevojshëm. Përkundrazi, është Autoriteti Kontraktues, si hartues i Dosjes së Tenderit, ai që duhet të justifikojë çdo kriter që vendos.

Kjo rrjedh drejtpërdrejt nga neni 49 i LPP-së, sipas të cilit kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcionale me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e saj.

Prandaj, barra e provës bie mbi Autoritetin Kontraktues, i cili duhet të dëshmojë se secili kriter:

është objektivisht i nevojshëm;

lidhet me punimet konkrete;

nuk mund të zëvendësohet me një kriter më pak kufizues;

nuk cenon konkurrencën.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë raport teknik, analizë profesionale, preventiv të komentuar apo dokument tjetër që të justifikojë kriteret e kontestuara. Për pasojë, konstatimi se Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur prova nuk mund të zëvendësojë detyrimin e vetë Autoritetit Kontraktues për të arsyetuar ligjshmërinë e kriterëve të vendosura.

VI. SHKELJA E NENIT 7 TË LIGJIT PËR PROKURIMIN PUBLIK

6.1 Shkelja e parimit të trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së lirë

Neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik paraqet një nga parimet themelore mbi të cilat ndërtohet i gjithë sistemi i prokurimit publik në Republikën e Kosovës. Ky nen obligon Autoritetin Kontraktues që gjatë hartimit të Dosjes së Tenderit dhe zhvillimit të procedurës së prokurimit të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, të mos vendosë kushte diskriminuese dhe të garantojë konkurrencë efektive.

Ky parim nuk nënkupton vetëm trajtim të njëjtë formal të operatorëve ekonomikë, por kërkon që edhe vetë kriteret e kualifikimit të jenë objektive, të arsyetuara dhe të mos favorizojnë operatorë të caktuar ekonomikë.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka vendosur një numër të konsiderueshëm kriteresh teknike dhe profesionale që nuk janë arsyetuar me asnjë analizë teknike apo profesionale dhe që tejkalojnë nevojat reale të kontratës.

Vendosja e një numri të madh pajisjesh me karakteristika tepër specifike, të përcaktuara sipas peshës minimale ose maksimale, pa shpjeguar arsyen teknike të këtyre kufijve, krijon pengesa artificiale për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe zvogëlon konkurrencën në mënyrë të pajustificuar.

Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar se këto kufizime janë të domosdoshme për realizimin e kontratës, ndërsa vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk përmban asnjë analizë që të justifikojë këto kufizime.

Prandaj, Dosja e Tenderit nuk garanton konkurrencë efektive, por krijon barriera të panevojshme për pjesëmarrje, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

6.2 Shkelja e parimit të proporcionalitetit

Parimi i proporcionalitetit është një nga parimet bazë të prokurimit publik dhe kërkon që çdo kriter kualifikues të jetë:

i përshtatshëm për arritjen e qëllimit;

objektivisht i nevojshëm;

masa më pak kufizuese për arritjen e qëllimit.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të vendosë kritere vetëm sepse konsideron se ato mund të jenë të dobishme.

Ai duhet të provojë se:

kriteri është i domosdoshëm;

nuk ekziston alternativë më pak kufizuese;

kriteri lidhet drejtpërdrejt me punimet konkrete.

Në rastin konkret nuk ekziston asnjë analizë e tillë.

Përkundrazi, Autoriteti Kontraktues është kufizuar vetëm në deklarinimin se kriteret janë proporcionale, pa shpjeguar mbi çfarë baze teknike ose profesionale ka arritur në këtë përfundim.

Një konstatim i tillë nuk përmbush standardin e proporcionalitetit të kërkuar nga LPP.

VII. SHKELJA E NENIT 49 TË LPP-së

Neni 49 i LPP-së përcakton qartë se kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional duhet të jenë:

të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës;
proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e saj.

Ky nen nuk i jep Autoritetit Kontraktues të drejtën të kërkojë çfarëdo pajisjeje apo profili profesional sipas vlerësimit subjektiv.

Përkundrazi, çdo kriter duhet të mbështetet në një analizë objektive të projektit dhe të punimeve që do të realizohen.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar se:

ekziston ndonjë pozicion i paramasës që kërkon ekskavator me zinxhir gome minimum 18 ton;
ekziston ndonjë pozicion që justifikon cilindër minimum 26 ton;

ekziston ndonjë pozicion që justifikon makinë frezë minimum 13 ton;

ekziston ndonjë pozicion që justifikon njëkohësisht tri pajisje të ndryshme për frezim;

ekziston ndonjë pozicion që kërkon traktor bujqësor/pyjor;

ekziston ndonjë pozicion që justifikon kufijtë maksimalë të vendosur për pajisje si spërkatësja për emulsion apo mini skip-i.

Në mungesë të një lidhjeje të tillë me projektin dhe paramasën, kriteret nuk mund të konsiderohen në përputhje me nenin 49 të LPP-së.

VIII. MUNGESA E ANALIZËS TEKNIKE NGA AUTORITETI KONTRAKTUES

Një element i rëndësishëm që mungon plotësisht në këtë procedurë është analiza teknike.

Në asnjë pjesë të vendimit nuk gjendet:

raport teknik;

mendim i projektuesit;

mendim i mbikëqyrësit;

analizë e projektit ekzekutiv;

analizë e paramasës;

analizë e teknologjisë së ndërtimit.

Përkundrazi, Autoriteti Kontraktues kërkon që operatorët ekonomikë të posedojnë një numër të madh pajisjesh shumë specifike, pa treguar se në cilin segment të punimeve ato janë të domosdoshme.

Një qasje e tillë është në kundërshtim me nenin 49 të LPP-së dhe me parimin e proporcionalitetit.

OSHP ka theksuar vazhdimisht në praktikën e saj se Autoriteti Kontraktues duhet të jetë në gjendje të justifikojë çdo kriter teknik me nevojat konkrete të kontratës. Mungesa e një justifikimi të tillë e bën kriterin të cenueshëm dhe të kundërligjshëm.

IX. MUNGESA E TRANSPARENCËS

Një pjesë e kriterëve të Dosjes së Tenderit janë formuluar në mënyrë të paqartë.

Për shembull:

"Kamion minimum 13 ton" – nuk sqarohet nëse i referohet peshës totale të lejuar apo kapacitetit bartës.

"Kamionetë me vinç deri 900 kg" – nuk sqarohet nëse 900 kg i referohet kapacitetit ngritës të vinçit apo peshës bartëse të automjetit.

"Spërkatëse për emulsion maksimum 1.7 ton" – nuk sqarohet nëse kufiri lidhet me peshën totale, kapacitetin e rezervuarit apo një parametër tjetër teknik.

"Mini skip me lopatë maksimum 3 ton" – nuk përcaktohet qartë se çfarë lloji pajisjeje kërkohet.

Paqartësia e këtyre kriterëve krijon pasiguri juridike dhe mundëson interpretime të ndryshme gjatë fazës së ofertimit dhe vlerësimit të ofertave, duke cenuar parimin e transparencës dhe të trajtimit të barabartë.

X. ANALIZA E KRITEREVE TË KONTESTUARA

10.1 KËRKESA NR. 12

Punëtor i certifikuar si Instalues i tubave të kanalizimit dhe ujësjellësit

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar posedimin e një punëtori të certifikuar si instalues i tubave të kanalizimit dhe ujësjellësit.

Operatori Ekonomik në kërkesën për rishqyrtim kishte argumentuar se, nga analiza e paramasës dhe e projektit, rezulton se punimet në rrjetin e ujësjellësit nuk përbëjnë objektin kryesor të kontratës, por vetëm ndërhyrje të kufizuara ndihmëse gjatë realizimit të punimeve rrugore. Për këtë arsye është kërkuar që Autoriteti Kontraktues të argumentojë bazën teknike dhe ligjore të këtij kriteri.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me këtë pretendim. Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk sqarohet:

cili pozicion i paramasës kërkon domosdoshmërisht një punëtor të certifikuar;

cili standard teknik e imponon këtë certifikim;

pse nuk mjafton përvoja profesionale ose stafi tjetër teknik;

pse ky kriter është proporcional me objektin e kontratës.

Vendosja e këtij kriteri pa një analizë të tillë bie ndesh me nenin 49 të LPP-së, pasi AK nuk ka dëshmuar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet certifikimit të kërkuar dhe punimeve konkrete.

Prandaj, kriteri është vendosur në mënyrë arbitrare dhe kufizon konkurrencën pa një bazë objektive.

10.2 KËRKESA NR. 13

Ekskavator me zinxhir gome minimum 18 ton

Autoriteti Kontraktues kërkon posedimin e një ekskavatori me zinxhir gome minimum 18 ton.

Ky kriter është përcaktuar ekskluzivisht mbi bazën e peshës së makinerisë, pa shpjeguar performancën funksionale që kërkohet.

Në procedurat e prokurimit publik nuk është pesha e makinerisë që garanton realizimin cilësor të kontratës, por kapaciteti teknik dhe funksional i saj.

Autoriteti Kontraktues nuk ka treguar:

pse kërkohet pikërisht minimumi 18 ton;

pse një makineri 16 apo 17 ton nuk do të ishte e aftë të realizonte të njëjtat punime;

në cilin pozicion të projektit mbështetet ky kufizim;

cili dokument teknik e rekomandon këtë peshë.

Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim mungon plotësisht çdo analizë mbi këto çështje.

Vendosja e kufijve sipas peshës, pa analizë funksionale, përbën kufizim artificial të konkurrencës dhe është në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 49 të LPP-së.

10.3 KËRKESA NR. 15

Makinë frezë për grryerjen e asfaltit minimum 13 ton

Nga paramasa rezulton se janë paraparë vetëm rreth 100 m² frezim të asfaltit ekzistues.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues kërkon posedimin e një makinerie frezë minimum 13 ton.

Autoriteti Kontraktues nuk ka shpjeguar:

pse një sasi kaq e vogël punimesh justifikon posedimin e një makinerie të kësaj kategorie;
pse kjo pajisje duhet të jetë në pronësi ose posedim të operatorit ekonomik;
pse nuk mund të sigurohet përmes nënkontraktimit ose pajisjeve ekuivalente;
pse pesha e makinerisë është elementi përcaktues.

Për më tepër, AK nuk ka shpjeguar termin "përpunim i asfaltit", ndërkohë që në paramasë parashihet vetëm frezim.

Kjo tregon mungesë të analizës teknike dhe e bën kriterin joproportional.

10.4 KËRKESA NR. 16

Frezë që montohet në bager maksimum 500 kg

Ky kriter paraqet një tjetër shembull të mungesës së proporcionalitetit.

Nga njëra anë, Autoriteti Kontraktues kërkon një makineri frezë minimum 13 ton.

Nga ana tjetër, kërkon edhe një frezë të montuar në bager maksimum 500 kg.

Më pas kërkon edhe frezë për eskavator mbi 1.1 ton.

Pra, për të njëjtin proces pune kërkohen tri pajisje të ndryshme, pa u shpjeguar funksioni specifik i secilës.

Autoriteti Kontraktues nuk ka argumentuar:

pse kërkohen të tre pajisjet njëkohësisht;
në cilat pozicione të paramasës përdoret secila;
pse njëra nuk e zëvendëson tjetrën.

Kjo përbën mbivendosje të pajustificuar të kriterëve dhe kufizon konkurrencën.

10.5 KËRKESA NR. 17

Kamion minimum 13 ton

Autoriteti Kontraktues ka përdorur termin:

"Kamion minimum 13 ton"

pa specifikuar:

nëse i referohet peshës totale të lejuar (GVW);

kapacitetit bartës (payload);

peshës vetanake të automjetit.

Në industrinë e transportit këta janë parametra krejtësisht të ndryshëm.

Një kamion me peshë totale 13 ton nuk është i njëjtë me një kamion me kapacitet bartës 13 ton.

Paqartësia e këtij kriteri krijon pasiguri juridike dhe rrezikon që ofertat të vlerësohen sipas interpretimeve të ndryshme.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka korrigjuar këtë paqartësi dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim në vendimin për rishqyrtim.

Prandaj, kriteri është në kundërshtim me parimin e transparencës dhe të trajtimit të barabartë.

0.6 KËRKESA NR. 18

Cilindër me peshë minimum 26 ton

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një cilindri me peshë minimale 26 ton, pa dhënë asnjë arsytim teknik mbi domosdoshmërinë e këtij kriteri.

Në kërkesën për rishqyrtim, Operatori Ekonomik kishte kërkuar që AK të identifikojë:

pozicionet konkrete të paramasës që kërkojnë këtë pajisje;

bazën teknike të përcaktimit të peshës minimale prej 26 ton;

analizën e ngjeshmërisë së kërkuar;

arsyet pse rezultatet e kërkuara nuk mund të arrihen me pajisje ekuivalente me peshë më të vogël.

Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk është dhënë asnjë përgjigje konkrete për këto pretendime.

Në praktikën inxhinierike, cilësia e ngjeshjes nuk përcaktohet vetëm nga pesha e cilindrit, por nga kombinimi i një sërë parametrash teknike, si:

amplituda e vibrimit;

frekuenca;

ngarkesa lineare;

numri i kalimeve;

karakteristikat e materialit që ngjeshet;

kërkesat e projektit.

Prandaj, përcaktimi i një peshe minimale pa analizë teknike nuk garanton cilësi më të mirë të punimeve.

Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar se një cilindër 20, 22 apo 24 ton nuk do të siguronte të njëjtin rezultat teknik.

Për rrjedhojë, kriteri është vendosur në mënyrë arbitrare dhe në kundërshtim me nenet 7 dhe 49 të LPP-së.

10.7 KËRKESA NR. 19

Traktor bujqësor/pyjor për pastrimin e shkurreve max. 600 kg

Ky kriter është një nga kriteret më të paqarta të Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk ka sqaruar:

çfarë nënkupton me termin "traktor bujqësor/pyjor";

nëse kufiri prej 600 kg i referohet traktorit apo pajisjes së montuar;

cili është funksioni konkret i kësaj pajisjeje;

në cilat pozicione të paramasës përdoret kjo pajisje.

Për më tepër, nuk është paraqitur asnjë analizë teknike që dëshmon se pastrimi i shkurreve nuk mund të realizohet me pajisje të tjera.

Një kriter i tillë nuk plotëson standardin e qartësisë që kërkon LPP.

Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të kuptojnë pa asnjë dyshim se çfarë pajisjeje kërkohet.

Në këtë rast kjo nuk është e mundur.

Paqartësia cenon:

transparencën;

trajtimin e barabartë;

sigurinë juridike.

10.8 KËRKESA NR. 20

Frezë për eskavator mbi 1.1 ton

Ky kriter paraqet shembull tipik të mbivendosjes së kërkesave teknike.

Në Dosjen e Tenderit kërkohen njëkohësisht:

makinë frezë minimum 13 ton;

frezë që montohet në bager maksimum 500 kg;

frezë për eskavator mbi 1.1 ton.

Autoriteti Kontraktues nuk ka shpjeguar:

funksionin e secilës pajisje;

dallimin ndërmjet tyre;

arsyen pse kërkohen të gjitha njëkohësisht;

në cilat pozicione përdoret secila.

Një kërkesë e tillë krijon barrë të panevojshme ekonomike për operatorët ekonomikë.

Në mungesë të analizës teknike, kriteri nuk mund të konsiderohet proporcional.

10.9 KËRKESA NR. 21

Kamionetë me vinç me peshë ngarkese deri 900 kg

Ky kriter është i paqartë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka specifikuar nëse kufiri prej 900 kg i referohet:

kapacitetit ngritës të vinçit;

peshës bartëse të automjetit;

ndonjë karakteristike tjetër teknike.

Një paqartësi e tillë lejon interpretime të ndryshme gjatë vlerësimit të ofertave.

Kjo është në kundërshtim me parimin e transparencës.

Përveç kësaj, Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar:

pozicionet e paramasës;

analizën funksionale;

bazën teknike.

Prandaj kriteri është i kundërligjshëm.

10.10 KËRKESA NR. 22

Spërkatëse për emulsion max. 1.7 ton

Autoriteti Kontraktues ka vendosur kufirin maksimal prej 1.7 ton.

Megjithatë nuk ka sqaruar:

nëse ky kufi i referohet peshës totale;

rezervuarit;

kapacitetit të pompës;

performancës së pajisjes.

Në praktikën profesionale, cilësia e aplikimit të emulsionit nuk përcaktohet nga pesha e pajisjes.

Përcaktues janë:

sistemi i spërkatjes;

saktësia e dozimit;

presioni;

kapaciteti funksional.

Autoriteti Kontraktues nuk ka argumentuar pse është zgjedhur kufiri 1.7 ton dhe pse pajisjet ekuivalente nuk do të ishin të pranueshme.

Prandaj, kriteri nuk është proporcional.

10.11 KËRKESA NR. 23

Mini skip me lopatë maksimum 3 ton

Edhe ky kriter është formuluar në mënyrë të paqartë.

Nuk përcaktohet:

nëse kërkohet mini dumper;

skid steer loader;

mini ngarkues;

pajisje tjetër.

Po ashtu nuk argumentohet:

pse kërkohet kufiri maksimal prej 3 ton;

në cilat pozicione përdoret;

pse pajisjet e tjera të kërkuara nuk janë të mjaftueshme.

Në mungesë të këtyre elementeve, kriteri nuk është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe nuk plotëson kërkesat e nenit 49 të LPP-së.

Nga analiza e secilit kriter rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur të provojë:

lidhjen e drejtpërdrejtë të kriterëve me objektin e kontratës;

domosdoshmërinë teknike të secilit kriter;

proporcionalitetin e tyre;

arsyen e kufijve minimalë ose maksimalë të vendosur;

pamundësinë e përdorimit të pajisjeve ekuivalente.

Për më tepër, në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk është dhënë asnjë analizë individuale për këto pretendime, por vetëm konstatime të përgjithshme. Kjo përbën shkelje të neneve 7, 49 dhe 108/A të LPP-së dhe e bën vendimin administrativ të paarsyetuar e të kundërligjshëm.

Operatori Ekonomik SEFERI-CO SH.P.K. kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

Ta aprovojë ankesën si të bazuar.

Të obligojë Autoritetin Kontraktues të korrigjojë Dosjen e Tenderit, duke eliminuar ose ndryshuar të gjitha kriteret teknike dhe profesionale që rezultojnë të jenë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, në mënyrë që ato të jenë:

të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës;

objektive;

proporcionale;

të qarta;

jodiskriminuese dhe të mos kufizojnë konkurrencën.